



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Ligjshmërisë

KA 34

K. Ankimore Nr. 34

Data 19.10.2023
Nr. Prot 7242

KËRKUES: KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

OBJEKTI: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

DREJTUAR: KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka administruar denoncimin nr. 402 ID, me kërkues Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj bashkisë Kamëz për të cilin pretendohet se nuk janë raportuar veprimtaritë publike në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim.

Indicia është marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, neni 91, 92, 171 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, i është kërkuar informacion personave përgjegjës për raportimin e veprimtarisë publike në institucionet shtetërore, në lidhje me veprimtarinë publike të paraportuar në ndërfaqe.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucioni publik nëpërmjet adresës së postës elektronike, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes të pretenduara.

Subjekti objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- Denoncimi nr. **402 ID**, *“Me Linditën, në mesin e shkrimtarëve, në ceremoninë e hapjes së edicionit të dytë të panairit të librit “Kamza Lexon”, me një larmishmëri aktiviteteve të emocioneve, i cili do të vijojë edhe në datat 6 & 7 Maj, me të pranishëm : Besnik Mustafaj (Politikan, diplomat, përkthyes dhe shkrimtar); Ben Blushi (Politikan, shkrimtar dhe gazetar); Namik Dokle (Politikan dhe gazetar); Të lumtur që Kamza për të dytin vit rradhazi promovon rëndësinë e librit në formimin dhe pasurimin kulturor. Ju ftojme të na bashkoheni nesër me aktivitete dhe shkrimtarë të tjerë! #KamzaLexon #PanairiLibrit.”*

Prova link:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02LDR6DJfCDwZhwFPzMXMDCBFtwnxp65QoM5SWpdDaLy5MeDkFWvW7615kZp2gvsfTI&id=100044332874482
https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid031mvLwMe7GYv18NEY5ALfwyEhFe4bahDtXF7ooYcTdkY1z2WvP5fWtvPGG1mNALcaI&id=100077339029573

Më datë 8.5.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, i është kërkuar informacion nëpërmjet adresës së postës elektronike në lidhje me denoncimin me nr. **402 ID**.

Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Bashkisë Kamëz, i është përgjigjur kërkesës tonë për informacion, ku jemi informuar se: *“Nga ana e bashkisë Kamëz është realizuar detyrimi ligjor për raportimin e veprimtarisë në fjalë me karakter publik. Sa më sipër, nga ana e bashkisë Kamëz është raportuar në ndërfaqen e raportimeve Panairi i Librit “Kamza Lexon”. Paqartësia nga denoncuesit është krijuar për shkak se ky aktivitet është shtyrë dhe është kryer disa ditë pas datës së cilës është raportuar. Në ndërfaqen e raportimeve do të shihet që është raportuar ky aktivitet.”*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan në këtë proces, duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt denoncimi nr. 402 ID, por palët nuk u paraqitën në këtë seancë.

Për sa më sipër, Bashkia Kamëz, në përgjigjen e saj ka sqaruar se aktiviteti është raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por nga hetimi administrativ vërehet se bashkia Kamëz, ka kryer dy aktivitete të këtij lloji për të cilat rezulton se në rastin e parë është raportuar në ndërfaqe ndërsa për eventin “Kamza Lexon”, nuk është bërë raportim.

Në përfundim të hetimit administrativ, u provua se aktiviteti i mësipërm, referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se: *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura*



për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”, veprimtaria e kryer në denoncimin e regjistruar me nr. 402, përbën veprimtari publike dhe mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor “Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”, Bashkia Kamëz ka pasur detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 3, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor “raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)”.

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohet se “shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”, pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, konstaton se personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kamëz, ka shkelur pikën 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenin 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:

- Z. Elvis Gjika, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Kamëz, gjobë në masën 3 000 (tre mijë) lekë.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendimin nr. 797, datë 6.10.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 402 ID, shkelje administrative”;



- Denoncimi nr. 402 ID;
- Komunikimi me personat përgjegjës nëpërmjet postës elektronike;
- Provat link.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,


Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:
M. Bardhi
I. Horanlliu
M. Kaja
A. Lamçe
Y. Merkaç



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 06 Tetor 2023

Nr: 797

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 402 ID NGA KOALICIONI PËR
REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ PERSONIT
PËRGJEGJËS, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 06 Tetor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

- KËRKUES:** Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)
- SUBJEKT:** Z. Elvis Gjika, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kamëz;
- OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike
- BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92, 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Nga organizata Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) është depozituar, indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike, nga 1 (një) institucion publik, për të cilin pretendohet se nuk është raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim.

Data: 06 Tetor 2023 Nr: 797
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 402 ID për shkelje administrative."

Indicia është marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Denoncimi është regjistruar me nr. 402 ID, me kërkues KRIIK, ku pretendohet si më poshtë vijon:

*“Me Linditën, në mesin e shkrimtarëve, në ceremoninë e hapjes së edicionit të dytë të panairit të librit “Kamza Lexon”, me një larmishmëri aktiviteteve e emocioneve, i cili do të vijojë edhe në datat 6 & 7 Maj, me të pranishëm : Besnik Mustafaj (Politikan, diplomat, përkthyes dhe shkrimtar); Ben Blushi (Politikan, shkrimtar dhe gazetar); Namik Dokle (Politikan dhe gazetar); Të lumtur që Kamza për të dytin vit rradhazi promovon rëndësinë e librit në formimin dhe pasurimin kulturor. Ju ftojme të na bashkoheni nesër me aktivitete dhe shkrimtarë të tjerë!
#KamzaLexon #PanairiLibrit*

Prova link:

https://ëëë.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02LDR6DJfCDëZhëFPzMXMDCBFtënxp65QoM5SËpdDaLy5MeDkFËvË7615kZp2qvsfTI&id=100044332874482

https://ëëë.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid031mvLëMe7GYv18NEY5ALfëvEhFe4bahDtXF7ooYcTdkY1z2ËvP5fËtvPGG1mNALcal&id=100077339029573”

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtarinë publike të raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 06 Tetor 2023 Nr: 797
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 402 ID për shkelje administrative.”

Më datë 8.5.2023, bashkisë Kamëz, i është kërkuar informacion në lidhje me një indicie të marrë nga denoncime regjistruar me nr. 402 ID, nëpërmjet adresës elektronike, ku jemi informuar se: *“Nga ana e bashkisë Kamëz është realizuar detyrimi ligjor për raportimin e veprimtarisë në fjalë me karakter publik. Sa më sipër, nga ana e bashkisë Kamëz është raportuar në ndërfaqen e raportimeve Panairi i Librit “Kamza Lexon”. Paqartësia nga denoncuesit është krijuar për shkak se ky aktivitet është shtyrë dhe është kryer disa ditë pas datës së cilës është raportuar. Në ndërfaqen e raportimeve do të shihet që është raportuar ky aktivitet.”*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan në këtë proces, duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt denoncimi nr. 402 ID, por palët nuk u paraqitën në këtë seancë.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, nëpërmjet vendimit nr. 686, datë 08.07.2023 “Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 403 ID për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 402 ID.

Pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27.07.2023, nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në përfundim të afatit për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim.

Në vijim të hetimit administrativ, palët në procesin administrativ, u njoftuan për të marrë pjesë në seancën publike të datës 06.10.2023, për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në seancë publike nuk u paraqit asnjë prej palëve të njoftuara.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ për denoncimin e regjistruar me nr. **402 ID**, pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, provohet se nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaria e kryera nga subjekti i denoncuar përbën veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor.

Bashkia Kamëz, në përgjigjen e saj ka sqaruar se aktiviteti është raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por nga hetimi administrativ vërehet se bashkia Kamëz, ka kryer dy aktivitete të këtij lloji për të cilat rezultoi se në rastin e parë është raportuar në ndërfaqe ndërsa për eventin “Kamza Lexon” nuk është bërë raportim.

Data: 06 Tetor 2023 Nr: 797
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 402 ID për shkelje administrative.”

Në përfundim të hetimit administrativ, u provua se aktiviteti i mësipërm, referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*, veprimtaria e kryer në denoncimin e regjistruar me **nr. 402**, përbën veprimtari publike dhe mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”*, bashkia Kamëz ka pasur detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 3, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor *“raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)”*.

Për sa më sipër, referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohet se *“shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor...nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”*, pasi kam vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, konstatoj se z. Elvis Gjika, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kamëz ka shkelur pikën 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

V E N D O S:

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për:

Data: 06 Tetor 2023 Nr: 797
Ora: 12:00




“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 402 ID për shkelje administrative.”

- Z. Elvis Gjika, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kamëz, gjobë në vlerën 3 000 (tremijë) lekë.

2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Njoftim per zgjatje afati (402 ID dhe 403 ID)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Mon 7/10/2023 3:52 PM

Bcc: info@kriik.al <info@kriik.al>; Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>; Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>; Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Përsëndetje,

Ju bëjmë me dije se, nëpërmjet vendimit nr. 686, datë 8 Korrik 2023 “Për zgjatjen e afatit të denoncimeve nr. 402 ID, 403 ID për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit tuaj.

Vendimin mund ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në rubrikën “Akte të KQZ”, “Akte të Komisionerit”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.



Re: Kërkesë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, bashkia Kamez (402)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Wed 10/4/2023 2:26 PM

To: Rebeka Sulejmani <rebekasulejmani98@gmail.com>

Cc: info@kriik.al <info@kriik.al>

Bcc: Ylli Merkaç <Ylli.Merkaç@kqz.gov.al>; Aurel Lamçe <Aurel.Lamçe@kqz.gov.al>; Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Përsëhëndetje,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, do të zhvillojë seancë publike, mbi hetimin administrativ të nisur ndaj Institucionit Tuaj.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ju keni të drejtën të paraqiteni vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegimet tuaja, ditën e premte, më datë 6 Tetor 2023, ora 12:00, në adresë Rr. “Ibrahim Rugova”, nr. 4, Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Sent: Thursday, July 27, 2023 1:47 PM

To: Rebeka Sulejmani <rebekasulejmani98@gmail.com>

Cc: info@kriik.al <info@kriik.al>

Subject: Kërkesë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, bashkia Kamez (402)

Përsëhëndetje,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka administruar denoncimin e regjistruar me nr. **402 ID**, me objekt mosrespektimin nga institucioni publik të detyrimit për raportim në ndërfaqen e raportimeve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtaritë publike.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në kuadër të hetimit administrativ të plotë dhe të gjithanshëm ka administruar të gjitha provat dhe pretendimet tuaja në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Duke qënë se ndodhemi në fazën e përfundimit të hetimit administrativ kërkojmë nga ana juaj paraqitjen e pretendimeve përfundimtare, me shkrim, lidhur me procesin administrativ, përpara se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të vijojë me vendimmarrje mbi këtë rast.

Përsa më sipër, afati për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare është brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e këtij njoftimi.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime
Sent: Monday, May 8, 2023 7:10 PM
To: Rebeka Sulejmani <rebekasulejmani98@gmail.com>
Cc: info@kriik.al <info@kriik.al>
Subject: Kerkese per informacion, bashkia Kamez (402)

Pershendetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 08.05.2023, në adresën e e-mail-it, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar raporti XVI i KRIIK Albania, për gjetjet dhe rekomandimet për javën 28 Prill - 4 Maj 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve. Nëpërmjet këtij raporti, është është marrë indicie për publikimin e 1 (një) veprimtarie si më poshtë vijon:

"1, 2, 3.... Filluam !

Me Linditën, në mesin e shkrimtarëve, në ceremoninë e hapjes së edicionit të dytë të panairit të librit "Kamza Lexon", me një larmishmëri aktivitësh e emocionesh, i cili do të vijojë edhe në datat 6 & 7 Maj, me të pranishëm :

Besnik Mustafaj (Politikan, diplomat, përkthyes dhe shkrimtar);

Ben Blushi (Politikan, shkrimtar dhe gazetar);

Namik Dokle (Politikan dhe gazetar); "" "

Të lumtur që Kamza për të dytin vit rradhazi promovon rëndësinë e librit në formimin dhe pasurimin kulturor .

Ju ftojme të na bashkoheni nesër me aktivitetet dhe shkrimtarë të tjerë ☺ !

#KamzaLexon

#PanairiLibrit

Prova link:

[https://www.facebook.com/permalink.php?](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02LDR6DjfCDwZhwFPzMXMDCBftwnxp65QoM5SWpdDaLy5MeDkFWvW7615kZp2gvsfTI&id=100044332874482)

[story_fbid=pfbid031mvLwMe7GYv18NEY5ALfwyEhFe4bahDfX7ooYcTdkY1z2WvP5fWtvPGG1mNALca&id=100077339029573 "](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid031mvLwMe7GYv18NEY5ALfwyEhFe4bahDfX7ooYcTdkY1z2WvP5fWtvPGG1mNALca&id=100077339029573)

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj informacion shpjegues në lidhje arseyne mosraportimit të veprimtarisë publike, brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijëni e këtij e-maili.

Ju informojmë se, referuar nenit 169, të Kodit Zgjedhor "Refuzimi për të bashkëpunuar me KQZ-në ose për të dhënë informacione që parashikohen nga ky Kod KQZ-së, nga ana e zyrtarëve të organeve të qeverisjes vendore ose qendrore, ndëshkohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë"

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.



Re: Kerkese per informacion, bashkia Kamez (402)

Rebeka Sulejmani <rebekasulejmani98@gmail.com>

Tue 5/9/2023 1:44 PM

To:denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Lënda: Informacion sqarues.

Të nderuar!

Fillimisht, duke shprehur konsiderata të larta për Ju dhe veprimtarinë që ushtroni, kërkojmë mirëkuptimin Tuaj!

Në mbështetje të Ligjit nr. 10019, datë 19.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar; Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve" si edhe në përgjigje të email-it tuaj, me anë të të cilit bazuar në raportin XVI i KRIIK Albania, për gjetjet dhe rekomandimet për javën 28 Prill - 4 MAJ 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve, ku nepermjet këtij raporti, është marrë indicie për publikimin e 1 (një) veprimtarie si më poshtë vijon:

*"1, 2, 3.... Filluam !**Me Linditën, në mesin e shkrimtarëve, në ceremoninë e hapjes së edicionit të dytë të panairit të librit "Kamza Lexon", me një larmishmëri aktiviteteve e emocioneve, i cili do të vijojë edhe në datat 6 & 7 Maj, me të pranishëm :**Besnik Mustafaj (Politikan, diplomat, përkthyes dhe shkrimtar);**Ben Blushi (Politikan, shkrimtar dhe gazetar);**Namik Dokle (Politikan dhe gazetar); "....."**Të lumtur që Kamza për të dytin vit rradhazi promovon rëndësinë e librit në formimin dhe pasurimin kulturor .**Ju ftojme të na bashkoheni nesër me aktivitete dhe shkrimtarë të tjerë ☺ !**#KamzaLexon**#PanairiiLibrit***Sa me siper, Ju sqarojmë se:**

Nga ana e Bashkisë Kamëz është realizuar detyrimi ligjor për raportimin e veprimtarisë në fjalë me karakter publik.

Sa me siper, nga ana e Bashkisë Kamëz është raportuar në ndërfaqen e raportimeve Panairi i Librit "Kamza Lexon".



Paqartesia nga denoncuesit eshte krijuar per shkak se ky aktivitet eshte shtyre dhe eshte kryer disa dite pas dates se ciles eshte raportuar. Ne nderfaqen e raportimeve do te shihet qe eshte raportuar ky aktivitet.

Theksojmë se: Bashkia Kamëz e ushtron veprimtarinë e saj në mbështetje e zbatim të legjislacionit rregullues, përfshirë këtu cdo akt ligjor e nënligjor në fuqi. Ju vëmë në dijeni se: Insitucioni ynë ka ndër marrë të gjitha masat me qëllim zbatimin e Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” si edhe cdo akti tjetër juridik me qëllim përgatitjen dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj,

On Mon, 8 May 2023 at 7:10 PM, denoncime <denoncime@kqz.gov.al> wrote:

Pershendetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 08.05.2023, në adresën e e-mail-it, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar raporti XVI i KRIIK Albania, për gjetjet dhe rekomandimet për javën 28 Prill - 4 MAJ 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve. Nëpërmjet këtij raporti, është marrë indicie për publikimin e 1 (një) veprimtarie si më poshtë vijon:

"1, 2, 3.... Filluam !

Me Linditën, në mesin e shkrimtarëve, në ceremoninë e hapjes së edicionit të dytë të panairit të librit "Kamza Lexon", me një larmishmëri aktivitetesh e emocionesh, i cili do të vijojë edhe në datat 6 & 7 Maj, me të pranishëm :

Besnik Mustafaj (Politikan, diplomat, përkthyes dhe shkrimtar);

Ben Blushi (Politikan, shkrimtar dhe gazetar);

Namik Dokle (Politikan dhe gazetar); "....."

Të lumtur që Kamza për të dytin vit rradhazi promovon rëndësinë e librit në formimin dhe pasurimin kulturor .

Ju ftojme të na bashkoheni nesër me aktivitete dhe shkrimtarë të tjerë ☺ !

#KamzaLexon

#PanairiiLibrit

Prova link:

[https://www.facebook.com/permalink.php?](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02LDR6DJfCDwZhwFPzMXMDCBFtnwpxp65QoM5SWpdDaLy5MeDkFWvW7615kZp2gvsfTI&id=100044332874482)

[story_fbid=pfbid02LDR6DJfCDwZhwFPzMXMDCBFtnwpxp65QoM5SWpdDaLy5MeDkFWvW7615kZp2gvsfTI&id=100044332874482](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02LDR6DJfCDwZhwFPzMXMDCBFtnwpxp65QoM5SWpdDaLy5MeDkFWvW7615kZp2gvsfTI&id=100044332874482)

[https://www.facebook.com/permalink.php?](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid031mvLwMe7GYv18NEY5ALfwyEhFe4bahDtXF7ooYcTdkY1z2WvP5fWtvPGG1mNALcal&id=100077339029573)

[story_fbid=pfbid031mvLwMe7GYv18NEY5ALfwyEhFe4bahDtXF7ooYcTdkY1z2WvP5fWtvPGG1mNALcal&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid031mvLwMe7GYv18NEY5ALfwyEhFe4bahDtXF7ooYcTdkY1z2WvP5fWtvPGG1mNALcal&id=100077339029573) "

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj informacion shpjegues ne lidhje arseyne mosraportimit te veprimtarise publike, brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e këtij e-maili.



Ju informojmë se, referuar nenit 169, të Kodit Zgjedhor "Refuzimi për të bashkëpunuar me KQZ-në ose për të dhënë informacione që parashikohen nga ky Kod KQZ-së, nga ana e zyrtarëve të organeve të qeverisjes vendore ose qendrore, ndëshkohet me gjobë nga 10 mijë deri në 50 mijë lekë"

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.



Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct



Panairi i Librit Bashkia Kamez

Bashkia Kamëz | 23/03/23 | Aktivitetet e raportuara

Aktivitet 3- ditor ne datat 14-15-16 Prill, viti i dyte i realizimit ne Bashkine Kamez

- Lloji i Aktivitetit: Tjetër
- Data:: 14/04/2023
- Ora:: 10:00
- Vendi i Zhvillimit:: Sheshi "Nene Tereza" Kamez
- Shteti: Shqipëri
- Qarku: Tirane
- Bashkia: Kamez
- Njësia Administrative: Kamez
- Folësit kryesorë:: Rakip Suli | Liridon Pjetra | Rigelsa Gupe
- Pozicioni: Kryetar i Bashkise | Shkrimtar | Drejtoreshe e Pallatit te Kultures
- Pjesëmarrësit: Rakip Suli, Liridon Pjetra, Rigelsa Gupe, Shkrimtare, Qytetare
- Me pjesëmarrjen e medias?: Jo
- I hapur për publikun?: Jo
- Personi përgjegjës për raportim: Drite Gerbolli, Drejtoreshe e Medias dhe Informacionit.
- Personi i ngarkuar nga ligji për raportim (Sekretari i Përgjithshëm/drejtori përgjithshëm/drejtuesi më i lartë administrativ): Elvis Gjika, Drejtor i Pergjithshem

